



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1371 / Prot. 2

Tiranë, më 26 /12/2017

VENDIM

Nr. 104, datë 26/12 /2017

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Shoqata "Intelektualët e Rinj, Shpresë" (IRSH), përfaqësuar nga Z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") ankesën nr. 1371 Prot., datë 16.10.2017, ndaj Autoritetit Publik, Bashkia Shkodër me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".

Ankuesi, me shkresën e datës 19.09.2017 ka kërkuar nga Bashkia Shkodër vënien në dispozicion të informacionit si më poshtë:

1. *Masat ligjore që janë ndërmarrë ose do të ndërmerrni ndaj personave përgjegjës në lidhje me mungesën e përgjegjshmërisë dhe transparencës ndaj publikut duke pasur parasysh shkeljet e panumërta të konstatuara dhe të faktuara në mënyrë të vazhdueshme nga organet ligjzbatuese në shoqërinë "Klubi i Futbollit Vllaznia" sh.a.!*
2. *Kopje të pagesave të kryera për ekzekutimin e detyrimit ndaj Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër në shumën prej 23.192.366 lekë për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi, i mbajtur në masën 15% për lojtarët e ekipit të parë si pjesë e rekomandimit të lënë nga KLSH për veprim të menjëhershëm (shih: fq 75 të raportit të KLSH).*
3. *Në lidhje me Vendimet e paligjshme të Këshillit Mbikqyrës për marrje borxhi në shumat prej 17.000.000 lekësh e 45.000 eurosh ju kërkojmë të na informoni në lidhje*

me emrat e personave fizik ose juridik tek të cilët janë marrë hua këto shuma si dhe na dërgoni kopje të kontratave të nënshkuara për marrjen e këtyre shumave!

- 4. Në lidhje me Vendimet e paligjshme të Këshillit Mbikqyrës për marrje borxhi në shumat prej 17.000.000 lekësh e 45.000 eurosh ju kërkjmë të na informoni në lidhje me masat e ndërmarra ligjore ndaj këtij veprimi në kundërshtim të hapur me ligjin.*
- 5. Duke qenë se llogaritë e shoqërisë "Klubi i Futbollit Vllaznia" sh.a vazhdojnë të mbeten të bllokuara ndërkohë që shoqëria vazhdon aktivitetin e saj tregtar dhe sportiv, ju lutem na informoni se në çfarë mënyre kryhen pagesat, çfarë llogarish përdoren, si bëhet kalimi i fondeve ndaj të tretëve!*
- 6. Ju kërkjmë të na informoni mbi shumën financiare të përfituar nga "KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA" sh.a nga transferimi i futbollistit dhe*
- 7. Ju kërkjmë të na informoni mbi afatin dhe shumën financiare për të cilën është lidhur kontrata nga "KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA" sh.a me futbollistin*
- 8. Ju kërkjmë të na informoni mbi afatin dhe shumën financiare për të cilën është lidhur kontrata nga "KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA" sh.a me futbollistin*
- 9. Ju kërkjmë të na informoni mbi afatin dhe shumën financiare për të cilën është lidhur kontrata nga "KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA" sh.a me futbollistin*
- 10. Ju kërkjmë të na informoni mbi afatin dhe shumën financiare për të cilën është lidhur kontrata nga "KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA" sh.a me futbollistin*
- 11. Ju kërkjmë të na informoni mbi afatin dhe shumën financiare për të cilën është lidhur kontrata nga "KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA" sh.a me futbollistin*
- 12. Ju kërkjmë të na informoni mbi afatin dhe shumën financiare për të cilën është lidhur kontrata nga "KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA" sh.a me futbollistin*
- 13. Ju kërkjmë të bëni transparente dhe të na informoni mbi procedurën e prokurimit të fondit prej 1 milion lekë për vlerësimin e asetëve të shoqërisë "KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA" sh.a, (ju lutem na dërgoni kopje të gjithë dokumentacionit që i përket procedurës së prokurimit, kopje të urdhrit të prokurimit, kopje të ftesave të ndryshme që i janë dërguar operatorëve të ndryshëm për të bërë vlerësimin etj)*
- 14. Në zbatim të gërmës dhj pika 1 të nenit 7 të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e Informimit" ju kërkjmë të publikoni në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër raportin e KLSH Mars 2017 në shoqërinë "KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA" sh.a.*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 1371 Prot., datë 16.10.2017 pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e

kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, me shkresën nr. 1371/1 Prot., datë 17.10.2017, përpara marrjes së vendimit, ka kërkuar nga Autoriteti Publik përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni brenda datës 24.10.2017.

Autoriteti Publik, nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 24.10.2017, ka dërguar bashkëlidhur shkresat nr. 13858 prot., datë 18.09.2017, nr.13978 Prot., datë 24.10.2017, si edhe shkresat e hartuara nga "Klubi i Futbollit Vllaznia" me nr. 291 prot., datë 15.09.2017, nr. 353 prot., datë 24.10.2017 duke përmbushur vetëm pjesërisht detyrimin për vënie në dispozicion të informacionit tek kërkuesi, dhe më konkretisht duke përmbushur detyrimin vetëm për pikat 2 dhe 13 më sipër.

Në këto kushte, ankuesi, nëpërmjet e-mail-it zyrtar ka vijuar ankimin pranë Zyrës së Komisionerit, duke kërkuar vënien në dispozicion të informacionit të plotë lidhur me pikat e tjera të kërkesës.

Autoriteti Publik pretendon se ankuesi është informuar nëpërmjet përgjigjes zyrtare për të gjitha kërkesat për informacion mbi "Klubin e Futbollit Vllaznia".

Me datë 13.11.2017, me kërkesën e Autoritetit Publik, Zyra e Komisionerit zhvilloi një seancë dëgjimore ku morën pjesë të dyja palët. Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e Autoritetit Publik dhe ankuesi rikonfirmuan qëndrimet e tyre të reflektuara dhe në aktet shkresore të trajtuara më sipër. Në përfundim të seancës u ra dakord që "Klubi i Futbollit Vllaznia" të argumentonte nëpërmjet një shkrese zyrtare pikat e kërkesës për informacion të ankuesit si dhe arsyet përse sipas tij këto të fundit përbëjnë informacion konfidencial.

Me anë të shkresës nr. 372 Prot., datë 14.11.2017, hartuar nga "Klubi i Futbollit Vllaznia" dhe dërguar në rrugë elektronike nga Autoriteti Publik, ky i fundit jep përgjigje për 5 pika të tjera të kërkesës duke përmbushur sërish vetëm pjesërisht detyrimin për vënie në dispozicion të informacionit tek ankuesi.

Informacioni i kërkuar në 7 pikat e tjera të kërkesës dhe më konkretisht mbi: - *shumën financiare të përfituar nga "Klubi i Futbollit Vllaznia" sh.a si rezultat i transferimit të futbollistit* dhe , si dhe *afatin dhe shumën financiare për të cilën është lidhur kontrata nga "Klubi i Futbollit Vllaznia" sh.a. me futbollistët* , - mbetet i papërmbushur.

Me argumentin se informacioni që kërkohet nuk mund të jepet pasi bie në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr. 9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, nenet 3, 6 dhe 15 të ligjit nr. 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, si edhe me nenin 40 "Konfidencialiteti Kontraktual" të Rregullores së Veprimtarisë Sportive të Federatës Shqiptare të Futbollit, Autoriteti Publik refuzon vënien në dispozicion të informacionit.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe konsultimit të legjisllacionit përkatës Komisioneri konstaton se baza ligjore ku mbështeten argumentet e Autoritetit Publik për refuzimin e vënies në dispozicion të informacionit nuk qëndron.

Neni 18 i Ligjit nr. 9901 datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar përmban dispozita lidhur me sekretin tregtar ku sekret tregtar konsiderohet: *“...një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument, që shoqëria mbron në mënyra të përshtatshme, i cili, nëse do t’u përhapej personave të paautorizuar, do të shkaktoje dëm të konsiderueshëm të interesave tregtarë të shoqërisë.”*

Nga shqyrtimi i pikave të kërkesës së ankuesit, Komisioneri vëren se asnjë prej tyre nuk përbën informacion përhapja e të cilit do t’i shkaktoje shoqërisë dëm nëse do t’i jepej të tretëve, për më tepër kur kemi të bëjmë me një shoqëri tregtare ku aksionet zotërohen nga një njësi e vetëqeverisjes vendore, pra me fonde publike.

Neni 15 i Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, përcakton të drejtën e subjektit të të dhënave personale, për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave të tij (që në këtë rast do të ishin futbollistët kontratat e të cilëve përbëjnë objektin e kërkesës), dhe jo të kontrolluesit të tyre, që në këtë rast është Autoriteti Publik.

Gjithashtu, informacioni i kërkuar nuk mund të përbëjë të dhënë personale në kuptim të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, përse kohë shumat që iu paguhen nga “Klubi i Futbollit Vllaznia” futbollistëve janë fonde publike.

Sa i përket konfidencialitetit kontraktual të sanksionuar në nenin 40 të Rregullores së Veprimtarisë Sportive të Federatës Shqiptare të Futbollit, ky nen përcakton se kontrata e lidhur midis klubit dhe lojtarit do të trajtohet në mënyrë konfidenciale dhe përmbajtja e saj nuk duhet të deklarohet apo shpërndahet, qoftë në mënyrë direkte apo indirekte ndaj asnjë personi, nga secila palë veç e veç, apo edhe të dyja palët së bashku, përveç disa rasteve përjashtimore të listuara nga vetë neni.

Bazuar në sa më sipër dhe konsideruar faktin që shumat që iu paguhen futbollistëve të “Klubit të Futbollit Vllaznia” janë fonde publike, si dhe interesin publik lidhur me këtë informacion, Komisioneri vlerëson se konfidencialiteti kontraktual nuk zbatohet në rastin konkret dhe informacioni duhet bërë publik.

Nga administrimi i provave, rezulton se një informacion i ngjashëm mbi shumën financiare të përfituar nga “Klubi i Futbollit Vllaznia” mbi transferimin e një futbollisti është bërë publik më parë, ndërkohë që në lidhje me kërkesën për informacion të paraqitur nga ankuesi (e cila ka për objekt informacion të së njëjtës natyrë) refuzohet të jepet.

Sa më sipër, informacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.*

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.*

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet

parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Për sa më sipër, në lidhje me ankesën e Shoqatës “Intelektualët e Rinj, Shpresë” përfaqësuar nga Z. _____ ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ai duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5, të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18, të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative” dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’.

V E N D O S A :

1. Pranimin e ankesës nr. 1371 Prot., datë 16.10.2017, të Shoqatës “Intelektualët e Rinj, Shpresë” përfaqësuar nga Z. _____ ndaj Autoritetit Publik “Bashkia Shkodër”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik “Bashkia Shkodër”, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës të datës 19.09.2017 në lidhje me pikat 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe më konkretisht lidhur me - *shumën financiare të përfituar nga “Klubi i Futbollit Vllaznia” sh.a si rezultat i transferimit të futbollistit _____ dhe _____, si dhe afatin dhe shumën financiare për të cilën është lidhur kontrata nga “Klubi i Futbollit Vllaznia” sh.a. me futbollistët _____ dhe _____* - brenda datës 08.11.2018.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u dha sot në datë 26.12.2017.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

